



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



NË MES TË

MINISTRISË SË DREJTËSISË

DHE

MINISTRISË SË PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

POLICISË SË KOSOVËS

PËR

FUNKSIONALIZIMIN E BAZËS SË INTEGRUAR E TË DHËNAVE PËR
RASTET E DHUNËS NË FAMILJE

Prishtinë, Mars 2019

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum i Bashkëpunimit (në tekstin e mëtejshëm: Memorandumi) ka për qëllim bashkëpunimin e Ministrisë së Drejtësisë me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Policinë e Kosovës për funksionalizimin e bazës së integruar e të dhënave për rastet e dhunës në familje.

Neni 2 Mundësia

Nënshkrimi i këtij Memorandumi është dëshmi se palët nënshkruese kanë për qëllim bashkëpunimin mes tyre duke i përcaktuar të drejtat dhe detyrimet mes tyre për funksionalizimin e bazës së integruar e të dhënave për rastet e dhunës në familje.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese

1. Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Drejtësisë janë:

- 1.1. Të menaxhoj dhe mirëmbaj sistemin e bazës së të dhënave;
- 1.2. Të ju ofroj statistika të përgjithshme nga sistemi i bazës së të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje të gjitha institucioneve kompetente;
- 1.3. Të garantoj mbrojtjen e sistemit nga çdo ndërhyrje;
- 1.4. Të përgatis raporte periodike statistikore për rastet e dhunës në familje;
- 1.5. Të kryej analiza vjetore për rastet e dhunës në familje;
- 1.6. Të marr në pronësi menaxhimin dhe mirëmbajtjen e plotë sistemit të bazës së të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje dhe kodin burimor pas përfundimit të marrëveshjen me Kompaninë "CACTUS";
- 1.7. Të avancoj dhe të plotësoj sistemin sipas nevojave që dalin pas analizave të plota;
- 1.8. Të korrigjoj shënimet e personave në rastet kur gjatë regjistrimit është bërë gabim, por pa qasje në shënimet e rastit;
- 1.9. Zyra e Koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ka të drejtë të shtojë në sistemin e bazës së të dhënave, institucionet që do t'i fusin të dhënat sipas nevojës;
- 1.10. Të nxjerr statistika për të gjitha shënimet në bazën e të dhënave;

- 1.11. Të harmonizoj të dhënat statistikore me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, me qëllim që të jetë në përputhje me indexin ndërkombëtar të statistikave;
- 1.12. Të publikoj raporte periodike për dhunën në familje;
- 1.13. Të njoftoj me raporte statistikore institucionet kompetente sipas kërkesave dhe nevojave;
- 1.14. Të monitoroj funksionimin e sistemit të bazës së të dhënave.

2. Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht Qendrave për Pune Sociale dhe Strehimoreve janë:

- 2.1. T'ju lejojnë qasje në sistem online zyrtarëve që janë të caktuar si menaxher të rastit;
- 2.2. Regjistrimi i shënimeve të përgjithshme të rasteve që trajtohen nga zyrtari, menaxheri i rastit;
- 2.3. Regjistrimi i shënimeve për viktimën në rast të ri;
- 2.4. Regjistrimi i shënimeve për palën përgjegjëse në rast të ri;
- 2.5. Regjistrimi i shërbimeve, përkatësisht veprimeve që i ofron për rastin;
- 2.6. Të ketë mundësi të shoh në bazën e të dhënave veprimet zyrtare nga akterët e tjerë;
- 2.7. Strehimoret nuk do të kenë mundësinë të shohin veprimet zyrtare nga akterët e tjerë;
- 2.8. Të nxjerr statistika për shërbimet e ofruara.

3. Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë:

- 3.1. I lejon gjyqtarit të rastit qasje në sistem online;
- 3.2. Regjistrimi i shënimeve për rastin, nga gjyqtaret që gjykojnë këto raste;
- 3.3. Regjistrimi i shërbimeve, përkatësisht veprimeve që i ofron për rastin;
- 3.4. Të ketë mundësi të shoh në bazën e të dhënave veprimet zyrtare nga akterët e tjerë;
- 3.5. Nxjerr statistikat për shërbimet e ofruara.

4. Të drejtat dhe detyrimet e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë:

- 4.1. I lejon Prokurorit të rastit qasje në sistem online;
- 4.2. Regjistrimi i shënimeve të prokurorisë për rastin, nga prokurori i rastit;
- 4.3. Regjistrimi i shërbimeve, përkatësisht veprimeve që i ofron për rastin;
- 4.4. Të ketë mundësi të shoh në bazën e të dhënave veprimet zyrtare nga akterët e tjerë;
- 4.5. Nxjerr statistikat për shërbimet e ofruara.

5. Të drejtat dhe detyrimet e Policisë së Kosovës janë:

- 5.1. I lejon hetuesit të rastit qasje në sistem online;
- 5.2. Regjistrimi i shënimeve të përgjithshme rasteve të dhunës në familje nga hetuesi i rastit;
- 5.3. Regjistrimi i shënimeve të viktimës, përkatësisht viktimave në rast të ri;
- 5.4. Regjistrimi i shënimeve për palën përgjegjëse në rast të ri;
- 5.5. Regjistrimi i shërbimeve, përkatësisht veprimeve që i ofron për rastin;
- 5.6. Të ketë mundësi të shoh në bazën e të dhënave veprimet zyrtare nga akterët e tjerë;
- 5.7. Nxjerr statistikat për shërbimet e ofruara.

Neni 4

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Palët nënshkruese marrin përsipër të zgjidhin çdo mosmarrëveshje eventuale si dhe të gjitha çështjet përkitazi me zbatimin e këtij Memorandumi me konsultime dhe negociata të drejtpërdrejta.

Neni 5

Ekzemplarët e Memorandumit

Ky Memorandum nënshkruhet në pesë ekzemplarë të njëjtë, nga një ekzemplarë për secilën palë.

Neni 6

Hyrja ne fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Palët nënshkruese:

Ministria e Drejtësisë

Abelard Tahiri
Ministër i Drejtësisë



Ministria e Punës dhe
Mirëqenies Sociale

Skënder Reçica
Ministër i Ministrisë së Punës
dhe Mirëqenies Sociale



Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Skënder Çoçaj
Kryesues i Këshillit Gjyqësor



Këshilli Prokurorial i Kosovës

Bahri Hyseni
Kryesues i Këshillit Prokurorial



Policia e Kosovës

Rashit Qalaj
Drejtor i Përgjithshëm



Prishtinë, më 14.03.2019